



Republika e Kosovës

Komuna e Drenasit

Kuvendi i Komunës



Nr. 12-060-57254 dt. 30.08 2019

PROCESVERBALI

I mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa të mbajtur më dt. 30.08.2019

Mbledhjen e kryesoi Labinot Halilaj-Kryesues.

Kryesuesi deklaroi të hapura punimet e mbledhjes të Komitetit për politikë dhe financa ku të pranishëm ishin anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa: Gani Podrimqaku, Blerina Gashi, Florentina Elezi, Fitore Morina, Edolina Plakiçi, Burim Bujupi.

Komiteti filloi punimet më këtë:

Rend dite:

1. Procesverbali i mbledhjes se kaluar.
2. Propozim vendimi i buxhetit Komunal për vitet 2020-2022.
3. Propozim vendimi për ndryshimin e anëtarit të Komitetit për Komunitete (i plotësuar).
4. Raporti i punës së Kryetarit të Komunës Janar-Qershor 2019.
5. Propozim vendimi për plotësim ndryshimin e Rregullores Komunale për Transparencë .
(i plotësuar).
6. Të Ndryshme.

Prezent gjatë mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa ish-in, Kryetari i Komunës z. Ramiz Lladrovci, përfaqësues të OSCE-së si dhe drejtor të drejtorive përkatëse.

Në mungesë të kryesuesit z. Gani Podrimqaku hapi mbledhjen e K.P.F-ca pasi përshëndeti të pranishmit kërkoj nga anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa a kanë diçka me shtu apo pajtohen me këtë rend dite?

Pasi nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime hodhi në votim rendin e ditës, ku të pranishëm ishin 5 anëtar:

Për votuan 05 anëtar

Kunder: 00

Abstenim: 00

z.Gani Podrimqaku hapi diskutimin për pikën e parë të rendit të ditës:

1.Procesverbali i mbledhjes së kaluar.

Pasi nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, ku të pranishëm ishin 5 anëtar:

Për votuan 05 anëtar

Kunder: 00

Abstenim: 00

z.Gani Podrimqaku hapi diskutimin për pikën e dytë të rendit të ditës: **2.Propozim vendimi i buxhetit Komunal për vitet 2020-2022.**

Drejtori i Financave- Shyqiri Bublaku, sa i përket raportit Financiar na ka ardh me kufijtë e përcaktuar në kategorinë e shpenzimeve gjegjësisht për investimet për komunën tonë dhe dua të ju njoftoj më këta kufijtë të cilët u dasht me iu përmbajt ne si Kuvend Komunal, numri i certifikuar i punëtorëve në Komunën e Drenasit është 1325 punëtor kështu ka qenë edhe vitin 2019. Buxheti për pagat për vitin 2020 është 9,544,810 € që dmth, ka një rritje bukur të mirë nese e krahasojmë me buxhetin e vitit 2018 dhe 2019 për shkak të ndryshimit të ligjit për paga në sektorin publik. Të mallra dhe shërbime e kemi buxhetin prej 1,793,263 € që është ky ka një rritje për shkak të objekteve të cilat po përfundojnë dhe të cilët duhet të kenë edhe mirëmbajtjen e tyre. Të shpenzimet komunale janë me 195,340€ buxhet vjetor, të subvencione dhe transfere e kemi një ngritje të vogël me 270,000€, të investimet kapitale ka ndiku rritja e buxhetit për paga dhe ka ndiku drejtpërdrejt ne zvogëlimin e shpenzimeve kapitale. Mirëpo prapë kemi rritje

më shumë se vitin e kaluar ku buxheti total është 16,490,343 € për vitin 2021 buxheti për paga rritet prapë 10,066,829 € për mallra dhe shërbime mbetet i njëjti nuk ka rritje për komunalë prapë nuk ka rritje dhe për subvencione dhe transfere nuk ka rritje edhe pse ne kemi kërkuar, ndërsa tek shpenzimet kapitale e kemi një ulje prej 4,686,930€ në 4,667,714 € gjithsej projeksioni për vitin 2021 është 16,993,146 €. Për vitin 2022 kemi për paga dhe meditje 10,500,477 dmth prapë kemi një rritje për mallra dhe shërbime është i njëjti për komunalë i njëjti për subvencione i njëjti për shpenzime kapitale kemi një rritje prej 4,786,279 € gjithsej buxheti total është 17,545,359 €. Buxheti është i ndarë për tre sektorë: buxheti për sektorin e përgjithshëm për vitin 2020 është 7,348,357 €, për sektorin e arsimit është 7,155,716 € dhe për sektorin e shëndetësisë është 16,490,343 €. E kemi edhe regjistrin e projekteve kapitale, ka pas edhe disa ndryshime të vogla por jo në shumën e investimeve kapitale apo nëpër drejtori por kemi mbrenda drejtorisë ndryshime në projekte kapitale psh. Investime për QKMF-në, në Administratë kemi 239,200 € ku parashihet mbi ndërtimi i objektit të komunës, drejtoria për shërbime publike dhe emergjencë i kemi 181,200 €, të infrastruktura publike i kemi 2,979,490, të gjeodezia dhe kadastër i kemi 155,000 €, këtu e kemi pas një ndryshim e kemi rrit shumën e shpronësimit por e kemi zvogëluar investimet tjerë, të Drejtoria për Planifikim Urban dhe mjedis e kemi shumën prej 83,000 €, tek shëndetësia dhe mirëqenie sociale e kemi shumën prej 363,520 €, të Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport e kemi buxhetin prej 221,100 €, në sektorin e arsimit e kemi 464,420 € nuk kemi parashikuar në sektorin arsimit investime më të mëdha për shkak se shkollat janë ndërtuar, numri i nxënësve po zvogëlohet për çdo ditë, këtë vit i kemi afër 500 nxënës më pak për atë shkak është zvogëluar edhe stafi i arsimit.

Florentina Elezi- disa gjera i kemi të paqarta, mbi ndërtimi i komunës si do të ndërtohet a nuk keni hapësirë të mjaftueshme? Rregullimi dhe mirëmbajtja e tregjeve për vitin 2020 nuk është paraparë fare, dhe e pati një vërejtje: tregu kur po mbahet çdo të enjte nuk po mirëmbahet fare se shumë po ndotet ajri, a shkojnë inspektorët me shiku ose ju a po e mirëmbani?

Drejtori i Financave- Shyqiri Bublaku, objekti është i mbingarkuar nuk kemi hapësirë sa duhet për gjithë punëtorët dhe është e nevojshme me u rrit objekti dhe nuk kemi vend ku me i lenë dokumentet dhe është paraparë me u rrit objekti.

Drejoresha për Shërbime të Qytetareve dhe Emergjencë- Lumnije Krap, kompania e mirëmban tregun, mirëpo edhe inspektorët shkojnë rregullisht e mbikëqyrin tregun, kompania i merr mbeturinat prej tregu, jemi duke punuar në këtë drejtim.

Kryetari i Komunës-z. Ramiz Lladrovci, puna e çështjes së tregut e ka kompania e mbeturinave përgjithësi edhe ata e kanë buxhetin e vet për mirëmbajtje, dhe inspektorët dalin për inspektim.

Burim Bujupi- a lejohet prerja e shpezëve në treg?

Kryetari i Komunës-z. Ramiz Lladrovci, nuk është e lejuar prerja e shpezëve as kafshëve në treg!

Florentina Elezi- përveç asfaltimit dhe kanalizimit të ujërave të zeza, desha me ditë çka po ndodh më ujësjellësin dhe kur kanë me pas qytetaret e Drenasit ujë?

Kryetari i Komunës-z. Ramiz Lladrovci, para disa viteve është shpall tenderi është përfunduar dhe mungojnë gypat e ujit, tani procesi është nën hetime dhe pas procedurave gjyqësore nuk kemi të drejt me zhvillu asnjë procedurë sa të përfundojnë këto procedura ne do të fillojmë më procedurat tutje.

Florentina Elezi- ndertimi i një qendre rinore e kemi dhënë një herë në kuvend qendrën për të rinj, por është total pa pajisje, e pse po doni me ndërtuar një qendër të re kur e kemi qendrën dhe atë me bërë funksionale dhe me be me pajisje. Furnizimi i shkollave me kabinete të biologjisë, fizikë mesa po kuptoj këtu qenka për shkolla fillore jo për shkolla të mesme, a ka me pas diçka edhe për shkolla të mesme se siç e dimë ne edhe ato janë të pa pajisura me laborator. Ndërsa një sqarim për QKMF-në kuptova që keni me ndertu një a mundeni me na sqaru pak ma shumë rreth kësaj çështje?

Shyqiri Bublaku- renovim me pajisje është, sa i përket shkollave këtë vit do t'i përfundojmë shkollat fillore pastaj do të shkojmë edhe me shkollat e mesme.

Kryetari i Komunës-z. Ramiz Lladrovci,- ne jemi në mesin e katër komunave që kemi fituar grantin prej 3 milion e gjysmë për ndërtimin e një QKMF-je të re, QKMF-ja e re do të ndërtohet në oborrin e QKMF-së aktuale të vjetër dhe participimi jonë 15% , e kemi paraparë për tri vjet.

Florentina Elezi- i falënderoj për përgjigjet, vota ime është për me shku në kuvend kjo pikë e rendit të ditës.

Fitore Morina- rregullimi i shtratit të lumit Drenica dhe Verbica, çka do të rregullohet, pasi është bërë thellimi i shtratit të lumit?

Idriz Hysenaj, ne edhe këtë vit kemi fillu me rregullimin e shtatit të lumit, ne e kemi një donacion me ministrinë e ambientit por nuk i kanë zhvilluar procedurat dhe jemi të rrezikuar me humb atë projekt dhe për këtë arsye ne duhet me pas të planifikuar në buxhet, nëse nuk realizohet ajo ne duhet me vazhdu me grand tonin .

Krytari i Komunës-z. Ramiz Lladrovci, projekti, rregullimi i shtratit të lumit Drenica dhe Verbica është një projekt i përbashkët por ne e kemi shpall tenderin deri në Komoran dhe tani ne duhet me shpall deri në fshatin Nekoc ku përfundon kufiri jonë administrative dhe ne këtë pjesë të lumit e kemi paraparë me buxhetin që e kemi fituar në grandin ta pastrojmë Kosovën. Këto mjete i kemi paraparë për vitin e ardhshme nëse këto mjete na qet ministria këtë vit atëherë ne i alokojmë diku tjetër.

Fitore Morina, rregullimi dhe zgjerimi i sheshit “Fehmi Lladrovci” si e keni paraparë këtë?

Krytari i Komunës-z. Ramiz Lladrovci, prej ku përfundon sheshi deri tek banka Raiffeisen ne e kemi parapare me zgjeru dhe rregulluar sheshin.

Kryesuesi i Kuvendit z. Labinot Halilaj hapi diskutimin për pikën e tretë të rendit të ditës 3. Propozim vendimi për ndryshimin e anëtarit të Komitetit për Komunitete (i plotësuar).

Pasi nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 7 anëtar:

Për votuan: 7 anëtar,

Kundër votuan 0 anëtar,

Abstenim votuan 0 anëtar.

Kryesuesi i Kuvendit z. Labinot Halilaj hapi diskutimin për pikën e katert të rendit të ditës:4. Raporti i punës së Kryetarit të Komunës Janar-Qershor 2019.

Fitore Morina- pati një vërejtje, mbledhje gjatë periudhes janar-qershor po shkruan se janë mbajtur 5 mbledhje të rregullta por me duket se janë mbajte 6 mbledhje.

Kryesuesi i Kuvendit z. Labinot Halilaj, gabim teknik e përmirësojmë.

Kryesuesi i Kuvendit z. Labinot Halilaj hapi diskutimin për pikën e pestë të rendit të ditës: **5. Propozim vendimi për plotësim ndryshimin e Rregullores Komunale për Transparencë.**

Krytari i Komunës-z. Ramiz Lladrovci, tek kjo pikë rendit të ditës është bërë vetëm një gabim teknik dhe na ka kthyer MAPL-ja.

Pasi nuk pati diskutime tjera, vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 7 anëtar:

Për votuan 7 anëtar,

Kundër votuan 0 anëtar,

Abstenim votuan 0 anëtar.

Kryesuesi i Kuvendit z. Labinot Halilaj hapi diskutimin për pikën e gjashtë të rendit të ditës: **6. Të ndryshme.**

Nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime.

Mbledhja përfundoj në ora 10:50 min.

Procesmbajtëse:

per Liridona

Liridona Fejza-Ajazi

Kryesuesi i Kuvendit Komunal
Labinot Halilaj
